REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E SHERBIMIT SOCIAL DHE KUJDESIT SHENDETESOR

Nr3624prot Lushnje, më 16.04.2026

RELACION

PËR NË KËSHILLIN BASHKIAK

KËTU

"MBI MIRATIMIN E FONDIT PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK - NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDET E BUXHETIT VENDOR PËR MUAJIN MARS 2026"

Të nderuar zonja dhe zotërinj këshilltarë!

Drejtoria e Shërbimit Social në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetë qeverisjen vendore", neni 54, ligji 9936 datë 26.06.2008 'Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar me Ligji nr. 115/2021 "Për buxhetin e Shtetit për vitin 2026". Ligji Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", VKM Nr. 597 datë 04.09.2019 "Për percaktimin e procedurave si dhe dokumentacionit dhe masën mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" si dhe Udhëzimit nr. 3 date 17.02.2017 "Mbi zbatimin e vendimit Nr. 955 datë 07.12.2016 të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e kritereve, procedurave, dokumentacionit dhe mases se perfitimit te ndihmes ekonomike" i ndryshuar, Udhëzimi Nr. 5 datë 17.02.2017 "Mbi përdorimin e fondit të kushtëzuar për bllok ndihmën ekonomike deri në 6%", të Ministrisë dhe Mirëqënies Sociale.

Në radhë të parë në këtë relacion informojmë Këshillin Bashkiak me VKM Nr. 868 datë 29.12,2021 'Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin Nr. 597, datë 4.09.2019, të Këshillit të Ministrave', "Për përcaktimin e proçedurave si dhe dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" pika 4.1,: Për familjet në nevojë, kryetari i familjes / njëri nga anëtarët madhorë, së bashku me bashkëshortin/en ose i vetëm kur nuk ka bashkëshort/e, kërkojnë të aplikojnë pranë administratorit shoqëror të seksioneve të ndihmës dhe të shërbimeve shoqërore në bashkinë/njësinë administrative, ku kanë vendbanimin, duke paraqitur dokumetacionin , si më poshtë vijon: ;

a) Kopjen e kartës së identitetit të aplikantëve;

b) Çertifikatën e pronësisë të lëshuar nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës/ vërtetimin e lëshuar nga Zyra e Kadastrës, apo aktin e marrjes në pronësi ose në përdorim të tokës për zonat ku regjistrimi i pronësisë nuk ka përfunduar ende;

c) Për rastet që janë në proces zgjidhje martese dhe ende nuk ka një vendim gjykate të formës së prerë, dokumentacioni i përcaktuar në pikën 4.1 të këtij kreu paraqitet i ndarë secili bashkëshort. Krahas këtij dokumentacioni paraqitet edhe vërtetimi i gjykatës që bashkëshortët janë në proces zgjidhjeje martese.

Masa e ndihmës ekonomike për çdo familje përllogaritet sipas Vendimit Nr. 868, datë 29.12.2021 Për disa mdryshime dhe shtesa në Vendimin Nr597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike".

- Familjet e përzgjedhura, në bazë të kritereve të përcaktuara dhe të miratuara, përfitojnë ndihmën ekonomike nga programi i bllok - ndihmës 6% të fondit të kushtëzuar dhe nga fondi i buxhetit vendor.

I. Kriteret për përfitues nga programi i bllok - ndihmës 6% nga fondi kushtëzuar.

a) Familjet në nevojë përzgjidhen nga lista e familjeve që kanë aplikuar brenda tre muajve të fundit, nëpërmjet regjistrit elektronik dhe që nuk janë shpallur fitues nga sistemi i pikëzimit.
b) Familja perpara se të përzgjidhet për tu trajtuar me këtë fond duhet të jetë verifikuar paraprakisht nga administratori shoqëror.
c) Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
d) Rastet kur kryefamiljari/ja ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.

II. Kriteret për trajtimin me fondet e buxhetit vendor:

a) Familjet të cilat kanë aplikuar për ndihmë ekonomike dhe nuk janë përzgjedhur si fituese nga sistemi.
b) Familja duhet të jetë familje në nevojë, të jetë pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme.
c) Rastet kur kryefamiljari ose dhe anëtarë të tjerë madhorë, të cilët janë të paaftë për të punuar, por për shkak të legjislacionit nuk përfitojnë pagesa PAK.
d) Familjet me kryefamiljare gra (të veja, të divorcuara, vajza nëna) me të paktën një femijë që ndjek arsimin bazë ose të lartë. e) Familje që kanë fëmijë në moshë madhore por që kanë probleme sociale (perdorues të lëndëve narkotike, probleme me ligjin etj) të cilët kanë vështirësi punësimi.
f) Familjet rome të cilat kanë probleme me rregjistrimin dhe transferimin.

g) Familjet me një anëtar që nuk kanë të ardhura apo i kanë të ardhurat e pamjaftueshme.

h) Prindër me shumë fëmijë.

- Ky projekt vendim nuk është akt normativ.

Drejtori Sherbimit Social
Anila Çela

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E SHERBIMIT PUBLIK E SOCIAL

Nr.3624/1 Prot

Lushnje, më 16/04/2026

PROJEKT-VENDIM

NR. 37 DATË 16/04/ 2026

"MBI MIRATIMIN E FONDIT PËR FAMILJET NË NEVOJË QË DO TË TRAJTOHEN ME NDIHMË EKONOMIKE DERI NË 6% TË FONDIT TË KUSHTËZUAR PËR BLLOK - NDIHMËN EKONOMIKE SI DHE PËR ATO QË DO TË TRAJTOHEN ME FONDET E BUXHETIT VENDOR PËR MUAJIN MARS 2026"

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës / /2026 në mbështetje të ligjit Nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeversijen vendore",Neni.3 shkronja "C",Neni22, Pika,1:Neni , 24;Pika 1; ligji 9936 datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 6,7 dhe 15,ligji Nr. 87/2025 ligji Nr.57 datë 18.07.2019 "Për Asistencen Sociale në Republiken e Shqipërise" neni 20 pika 4 germa *b* dhe *c* ", neni 21, si edhe VKM nr 597 datë 14.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave të dokumentacionit dhe masës së Ndihmës Ekonomike dhe përdorimin e fondit shtese mbi Fondin e Kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike", i ndryshuar kreu IV pika 1,2 dhe 3, ju

PROPOZOJMË:

1. Të trajtohen me Ndihmë Ekonomike familjet të dala nga sistemi i pikëzimit, pa pikë të mjaftueshme dhe që kane aplikuar të paktën 3 (tre) muaj, pasi i është bërë edhe verifikimi në familje do të trajtohen me ndihmë ekonomike me fond deri në 6 % të fondit të kushtëzuar (të rekomanduar nga sistemi).
2. Të paguhen në muajin MARS **me fondin 6 %** gjithësej 33 familje, 71 anetare, me fond 148.378 lekë nga të cilat 5152 lekë për kompesimin e energjisë elektirke.
3. Të paguhen ne muajin MARS me **Buxhetin e Bashkisë** gjithësej 102 familje, 202 anetare me fond 323.800 lekë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Sherbimit Social dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Drejtori Shërbimit Social
Anila Çela

Drejtori Juridik
Bedri Hida

Kryetari i Bashkisë
Eriselda Sefa

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE